



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:174002  
Datë: 15.07.2024  
Numri i dokumentit: 05937932

CAJK.nr.123/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Naim Mehulli dhe Ardian Ajvazi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesve M.R, L.R, A.R, B.R, R.R.H nga Ferizaj, të cilët me autorizim e përfaqëson av. V.M, ndaj kundër propozuesit A.R.1 nga Ferizaj, të cilët me autorizim e përfaqëson av. I.M në çështjen juridike masë e përkohshme e sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2023:174003, i datës 01.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET e pa themeltë ankesa e propozuesve M.R, L.R, A.R, B.R, R.R.H nga Ferizaj ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.2023:174003, i datës 01.09.2023 në pikën II sa i përket shpenzimeve të procedurës VËRTETOHET.

II.Pika I e dispozitivit të aktvendimit mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.2023:174003, i datës 01.09.2023 ka vendosur si në vijim:

*“I.KONSTATOHET E TËRHEQUR – propozimi i propozuesve M.R, L.R, A.R, B.R, R.R.H nga Ferizaj, ndaj kundër propozuesit A.R.1 nga Ferizaj, në çështjen juridike masë e përkohshme e sigurisë.*

*II.DETYROHEN – të propozuesit që në mënyrë solidare ti paguajnë kundër propozuesit shpenzimet e procedurës dhe atë në shumën prej 811.<sup>00</sup>€ (tetëqind e njëmbëdhjetë e euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit.”*

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë propozuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të shkeljeve të shpenzimeve të procedurës, me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet në pikën II të dispozitivit sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e propozuesve është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se propozuesit kanë paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme me datë 15.08.2023, kundër kundërpropozuesve me të cilin kanë kërkuar që të caktohet masa e përkohshme dhe të urdhërohen kundërpropozuesit menjëherë të ndërprejnë çdo veprim në punimin e ngastrës me numër 98 dhe numër 205 deri në përfundimin e çështjes si dhe ti ndalohej kundëropozuesiti që të ndaloj çfarëdo veprimi në drejtim të punimeve të pronës private sipas qëllimeve të tij ë pronën private të propozuesve ngase është shkaktuar dëm i pa riparueshëm, si dhe ti ndalohej çfarëdo veprimi në drejtim të tjetërsimit të pronës së paluajtshme deri në përfundim të çështjes me padi, më konkretisht me arsye sikurse në propozim.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të propozimit ka mbajtur seancën dëgjimore ku pas mbajtjes së seancës ka nxjerrë aktvendimin, C.nr.2023:174003, i datës 01.09.2023 me të cilin është konstatuar i tërhequr propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se duke vepruar në bazë të këtij propozimi caktoi dhe mbajti shqyrtimin kryesor, në të cilin i autorizuari i propozuesve në fjalën përfundimtare e tërhoqi propozimin për caktimin e masës së përkohshme, duke e konsideruar të përfunduar këtë çështje pasi më nuk kanë interes juridike për vazhdimin e kësaj procedure. Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi duke aplikuar nenin 456 të LPK-së, duke e detyruar propozuesit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës kundër propozuesit dhe atë për një seancë gjyqësore në shumën prej 811 €.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.2023:174003 të datës 14.09.2023, ka bërë përmirësimin e aktvendimit C.nr.2023:174003 të datës 01.09.2023, në këshillën juridike ku është shënuar se kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa. Ndërsa duhet të jetë kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh. Pjesa tjetër e aktvendimit mbetet e pandryshuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, si dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar, vlerëson se këto pretendime nuk janë të themelta dhe se drejtë është vendosur nga Gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se propozuesit kanë paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ku pas pranimit të këtij propozimi Gjykata e shkallës së parë ka caktuar dy seanca dëgjimore ku në këto të dyja kanë marrë pjesë propozuesit vazhdimisht.

Kjo gjykatë vlerëson se pavarësisht se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.2023:174003 të datës 01.09.2023 me të cilin në pikën I të dispozitivit të aktvendimit është konstatuar e tërhequr propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndërsa në pikën II të dispozitivit i janë njezur shpenzimet e procedurës kundërshtarit të sigurimit, ku në këshillën juridike nuk i është dhënë e drejta në ankesë. Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.2023:174003 të datës 14.09.2023, ka bërë përmirësimin e aktvendimit C.nr.2023:174003 të datës 01.09.2023, në këshillën juridike ku është shënuar se kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa. Ndërsa duhet të jetë kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh. Pjesa tjetër e aktvendimit mbetet e pandryshuar.

Në seancën e mbajtur me datë 01.09.2023, rezulton se kanë marrë pjesë propozuesit si dhe vetë përfaqësuesi i autorizuar i propozuesve, avokat V.M ku gjatë seancës janë deklaruar lidhur me propozimin, janë administruar prova në kuptim të themelësisë së caktimit të masës së sigurisë, e krejt në fund në fjalën përfundimtare propozuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar janë deklaruar që tërhiqen nga propozimi për caktimin e masës së përkohshme si dhe nuk i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

Neni 456.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se: ” 456.1 Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit.”

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret propozuesit kanë për detyrim që të paguajnë shpenzimet e procedurës palës kundërshtare për faktin se të njëjtit e kanë tërhequr propozimin e tyre në fund të procedurës, konform nenit të sipërcituar dhe se pretendimet në ankesë se Gjykata ka mundur që të veprojë lidhur me propozimin për masën e përkohshme të sigurisë pa mbajtur seancë fare, tani për Gjykatën e Apelit janë të pa themelta dhe pa ndikim për një vendosje ndryshe pasi që propozuesit si dhe përfaqësuesi i tyre asnjëherë nuk e kanë kundërshtuar mbajtjen e seancës dëgjimore dhe se vazhdimisht kanë marrë pjesë në këto seanca.

Pala kundërshtare me rastin e paraqitjes së propozimit kundër tyre ka pasur shpenzime procedurale të cilat janë shkaktuar me iniciimin e procedurës, andaj edhe konform dispozitave ligjore duhet që t’iu kompensohen shpenzimet e procedurës, ashtu siç është vendosur me të drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë të pashqyrtuar pikën I të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar pasi që nuk kishte pretendim ankimor lidhur me atë pikë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, 209.1 pika b) e LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAJK.nr.123/2024, me datë 15.07.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.